# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-438518**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Intervista në Syri.net - Meta: Ahmetaj është kthyer në një institucion kyç që po lufton organizatën kriminal e (PJESA E DYTË) |
| ADRESA | `https://www.syri.net/politike/916181/meta-ahmetaj-eshte-kthyer-ne-nje-institucion-kyc-qe-po-lufton-organizaten-kriminale-pjesa-e-dyte/` |
| BURIMI | syri.net |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 12 shtator 2026, 14:50:23 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 12 shtator 2026, 14:38:50 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `2df40ad335a5e050a59ba2743350a7ab673e717849bf3cc6f4748de4e875a3b0` |
| TEKSTI | `c9a081393d8791dc868e9bfbe0a93334bc18d7f9dd3d397c96c2250eb9382890` |
| PAMJA | `343a1925b69881e01dff8a964af5ccf36807baff6883daf42afd1812cda3d252` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `e6c78d5995c0aa41c5daddb4bec58db1361e18faeefecd3c399dccc6ceda6990` |
| E MËPARSHMJA | `2caca8f4591f33e699a7d3de7c2aad7edb36f82c762fabff9325882b614bfb11` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/e6c78d5995c0aa41c5daddb4bec58db1361e18faeefecd3c399dccc6ceda6990`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

Meta: Ahmetaj është kthyer në një institucion kyç që po lufton organizatën kriminale (PJESA E DYTË)

# Meta: Ahmetaj është kthyer në një institucion kyç që po lufton organizatën kriminale (PJESA E DYTË)

**ZMADHO TEKSTIN 16:38, 12/09/2026**

+ Aa -

*Presidneti i Partisë së Lirisë, Ilir Meta reagoi lidhur me denoncimet e forta të ish-numrit 2 të qeverisë, Arben Ahmetaj, në emisionin Çim Peka Live për trafikun ndërkombëtar të armëve. Në një intervistë për syri.net nga qelia, Meta tha se Ahmetaj është kthyer në një institucion kyç që po lufton organizatën kriminale, siç e cilëson ai qeverinë e Edi Ramës.*

Teksa opozita denoncon se modeli KAYO po përsëritet edhe në shëndetësi, Meta kishte një apel për ministren e re të Shëndetësisë, Klodiana Spahiu.

**Pjesa e dyte e Intervistes**

**Pyetje:** Meqënëse përmendët Ermal "Raketën" dhe Ron Yeffet, a besoni në akuzat e ish-Zv/Kryeministrit Ahmetaj?

**Ilir Meta:** I vetmi fakt që kam vënë në dyshim nga Z. Ahmetaj ka qenë vërtetësia e verës 33 mijë euro që pinte Edi Rama me Gysin dhe të tjerë.
Por kur u sekuestrua "pa dashje" kantina prej 3 milion euro isha i detyruar ta besoja.
Akoma më shumë kur kjo provë material tejet voluminoze "avulloi" brenda natës me dashje u binda edhe më shumë.
I përndjekuri nga organizata kriminale si djali plangprishës sot është kthyer në një institucion kyç që po lufton me fakte tronditëse organizatën kriminale, që qeveris vendin.
Çfarë nuk është vërtetuar nga faktet e tij të mëparshme?

**Pyetje:** Por a mund të jetë ai i besueshëm që aq kohë që i shmanget drejtësisë?

**Ilir Meta:** Cilës drejtësi? Asaj që urdhërohet nga Edi Rama, i cili tha publikisht se po të ishte ai gjykatës i Ahmetaj do të ishte më i ashpër?
Përse? Se nuk firmosi që borxhin publik ta menaxhonte Roni? Apo sepse me shkresa zyrtare ka kundërshtuar që faturën e inceneratorëve ta paguante buxheti i shtetit?

Apo për çështjen "pabukë" të bukës?

E besoj plotësisht skenarin e eleminimit të tij fizik "rastësisht" në paraburgim pasi kështu i vihej kapak edhe aferës së inceneratorëve, ku Ahmetaj nuk ka asnjë firmë dhe përgjegjësi personale, por edhe u tregohej të gjithë të pabindurve për të firmosur symbyllurazi çdo aferë të kreut të organizatës se si do të përfundonin.

Edhe kërcënimet ndaj fëmijës së tij dhe familjes së tij janë shumë të besueshme.
A nuk u kërcënuan të afërmit e deputetes Marjana Koçeku për shkak të kritikave të saj publike?

A nuk u kërcënuan të afërmit e zonjës Spiropali për shkak të kritikave të saj?

Kam një pyetje për të gjithë kritikët e Ahmetaj, të sponsorizuar nga regjimi. Si do mbronte veten ky politikan në një regjim gjyqësor që po përjashton edhe gazetarët e pavarur nga procesi i gjykimit dhe që bullizon edhe avokatët?

A mund t'i ekspozonte ai të gjithë ato fakte në interes të publikut nëse do ishte në paraburgim?

Vetëm pse unë iu përgjigja dy-tre pyetjeve të gazetares Beti Njuma u dënova në mënyrën më kriminale nga regjimi për një vit dhe për tre jave këta kriminelë nuk lejuan motrën time të më takonte.

Si do komunikonte Z. Ahmetaj me publikun, kur dihet se disa gazetarë edhe pse kanë marrë leje prej një viti nga SPAK për të më intervistuar mua nuk lejohen?
Kjo nuk ka ndodhur as në Rusinë e Putinit.

Ndaj Ahmetaj po i bën shërbime historike vendit dhe kombit duke denoncuar me fakte dhe prova organizatën kriminale, e cila është e tillë së pari në kuptimin penal për shkak të organizimit dhe qëndrueshmërisë së saj në kohë.

Vetëm grabitja e qindra milion euro publike përmes modelit “Kayo” në shumë sektorë e provon këtë penalisht.

Dhe së fundmi, duke e uruar Ministren e re të Shëndetësisë për detyrën e saj dhe meqënëse e njoh prej kohësh, jo vetëm për të mirën e saj, i kërkoj të mos firmosë symbyllurazi, pavarësisht nga “besa” e Akrepit.

Sepse kur kurban i “Besës” u bë edhe Besforti nuk do shumë mend të parashikosh edhe fatin e të tjerëve.

Pse i marrë ishte Shkëlqim Cani që pranoi më mirë të largohej se sa të bëhej kokë turku?

Jo, sepse ai e dinte rëndësinë e firmës dhe se ç’ndodh kur firmos “fap fap”.

Të gjithë duhet të reflektojnë sa më parë për të mirën e tyre.
Përndryshe gjithçka konsiderohet me dashje.

© SYRI.net

**Lexo edhe:**

- Rama pritet me protesta në Vlorë, policia tërheq zvarrë aktivistin Baki Goxhajn dhe 3 të tjerë, shpërthen qytetarja: Kriminelë
- Rama pritet me protesta në Vlorë, qytetari: Doni të na impononi si doni ju. Jo! Vij nga Italia kërkoj të drejtat e mija
- Intervista - Vizita e Berishës në SHBA/ Meta: Non-grata ra moralisht kur hodhi në gjyq Blinkenin dhe politikisht me Kuvendin e 11 Dhjetorit

Më të lexuarat
Politikë

## Sula: PISA 2025 u shënua me yll, OECD e futi Shqipërinë në ‘raportim të kufizuar’, qeveria fshehu të vërtetën

Politikë

## SYRI TV/ Ermal Nufi i ikën si ‘raketë’ pyetjeve të Syri Tv për audiopërgjimin

Politikë

## SYRI TV/ ‘Kufizimi i takimeve të Metës, shqetësim serioz’ , Komiteti i Helsinkit letër paraburgimit 313

Politikë

## Modeli Kayo, Bozdo: Janë krijuar 20 kompani, kanë marrë monopolin në disa fusha

Politikë

## Noka në 80-vjetorin e Kryengritjes së Postribës: Liria nuk dhurohet, për të duhet luftuar

Politikë

## SYRI TV/ Ngërçi për pagat e gjyqësorit përfundon në dyert e SPAK

Politikë

## SYRI TV/ Debate për audiopërgjimin e Ahmetajt, PD kërkon seanca dëgjimore për aferën

Politikë

## Kayo-Qeveria dhe Rama lakuriq, përse SPAK-u fshihet dhe nuk i sheh?

Politikë

## Bardhi: Rama hesht për audiopërgjimin ku miku i tij, Ron Yeffet, flet si i zgjedhur nga qeveria për të bërë punët e saj të këqija

Politikë

## Berisha në Konventën Republikane në Dallas - Takime me drejtues të Departamentit të Drejtsisë, Takime me senatore

**TË NGJASHME**

Politikë

## Vajza e Sali Mustafës: Drejtësia s’mund t’i barazojë çlirimtarët me xhelatët serbë

Politikë

## Hamza për gjyqtarët e Hagës: Mendoni për pasojat! Vendimi i padrejtë do ishte dënim për Kosovën! Kur preket UÇK-ja, ne ringrihemi

Politikë

## 'Liria ka Emër!'/ Në marshim morën pjesë rreth 100 mijë qytetarë

Politikë

## Bardhi: Tani që ra alibia e Edi Ramës, Pse SPAK nuk sjell në Kuvend kërkesën për arrestimin e Belinda Ballukut?

Politikë

Politikë

## Protesta në Memaliaj, Rama ndryshon itinerarin: Largohet me helikopter

Politikë

## SYRI TV/ Diaspora i bashkohet protestës, autokolona u bllokua në Mal të zi, hyri në Shqipëri përmes Kukësit

Politikë

## 28 vite nga vrasja e Azem Hajdarit/ Berisha: Azem, ti je gjallë! O sot o kurrë, në sulm!




SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Search

Denonco

Merrni lajmet më të fundit nga SYRI.net në çdo moment dhe kudo që të jeni!

Në rregull


Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.